



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA IV**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 78

Prishtinë, më 24.5.2013, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N- 225

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE  
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Danush Ademi.

**Mungoi:** Fatmir Xhelili dhe Goran Marinković

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Naim Hoxha, këshilltar nga OSBE- ja; Dhurata Kryeziu, OSBE; Visar Rushiti, GAP; Blerta Bejtullahu, Zyra e BE-së- Kosovë; Naim Hajdari, EULEX; Sanije Berisha, OSBE; Luanda Domi, DCAF, Venera Gashi-praktikante.

**Nga Stafi Mbështetës i Komisionit:** Nur Çeku, Haxhi Xhemajli, Zarife Aliu dhe Antigona Ibraj.

**Mbledhjen e kryesoi:** Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 17.05.2013;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-173 për përgjimin e telekomunikimeve;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Komisionarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Forcën e Sigurisë dhe Policinë e Kosovës;

5. Të ndryshme.

*Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.*

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 17.05.2013**

Procesverbali i mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 17.05.2013, u miratua pa ndryshime.

### **3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-173, për përgjimin e telekomunikimeve**

**Kryetari i Komisionit-** Njoftoi se nga takimet e kaluara që ka pasur grupi punues për Projektligjin për përgjimin e telekomunikimeve, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, si dhe grupi punues nga Komisioni për Mbikëqyrjen e AKI-së, kanë realizuar takime me të gjithë aktorët, dhe në fund të këtij procesi, kanë rënë dakord që të dy komisionet të marrin vendim.

Komisioni për punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, si Komision raportues, duhet të marrë vendim. Nga mbledhja e kaluar është rëndë dakord që projektligji të shkojë në seancë, por nuk është marrë vendim nëse duhet të miratohet apo të mos miratohet në parim.

Pasi ka dallime në Komision për këtë çështje, nëse projektligji duhet të miratohet në parim në seancë plenare, apo nuk duhet të miratohet në parim, konsideroj se këtë çështje duhet ta hedhim në votim

**Kryetari** konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me katër vota për( Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Vjollca Krasniqi, Anton Quni) dhe një votë kundër,( Ganimete Musliu ), si dhe dy abstenime( Danush Ademi, Rasim Demiri), nxori këtë:

### **REKOMANDIM**

*Të mosmiratohet në parim Projektligji nr. 04/L-173 për përgjimin e telekomunikimeve.*

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit për Komisionarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Forcën e Sigurisë dhe Policinë e Kosovës**

**Kryetari i Komisionit-** Falënderoi anëtarët e grupit punues që kanë punuar në draftimin e Projektligjit për Komisionarin për Forcën e Sigurisë dhe Policinë e Kosovës.

Gjithashtu, falënderoi organizatat që e kanë mbështetur këtë proces, siç është GIZ-i, ish-Komisionari i Forcave të Armatosura të Gjermanisë, z. Reinhold Robbe. Fjalën ia dha z. Rexhep Selimi, kryesues i grupit punës për Komisionarin për FSK-në dhe PK-në.

**Rexhep Selimi-** Theksoi se e vlerëson punën e grupit punës që ka hartuar këtë projektligj, duke vlerësuar se janë bërë hapa të duhur deri në këtë nivel, duke vazhduar më tutje me procedimin e tij në Kuvend, me qëllimin që ky ligj të jetë në funksion të FSK-së dhe PK-së.

Prandaj, kërkoj nga Komisioni që Projektligji për Komisionarin për FSK-në dhe PK-në, të mbështetet në procedurat e mëtutjeshme.

**Kryesuesi** konstatoi se *në këtë pikë të rendit të ditës, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me votim unanim, mori këtë*

#### **VENDIM**

*Projektligji për Komisionarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Forcën e Sigurisë dhe Policinë e Kosovës, procedohet për shqyrtim në seancë plenare.*

#### **5. Të ndryshme**

**Danush Ademi-** Theksoi se në komunikacion, makinat e llojit “pick up” po e rrezikojnë komunikacionin dhe për këtë konsideroi se është e nevojshme ndërmarrja e masave, pasi shkaktohen aksidente të shpeshta. Për këtë arsye, propozoi që t’i bëhet një shkresë Policisë së Kosovës që të marrin masa.

**Kryetari i Komisionit-** Këtë çështje mund ta ngremë tek Policia e Kosovës në takimet e rregullta me drejtorin e Policisë dhe Inspektoratin Policor.

**Rexhep Selimi-** Çështja e komunikimit të z. ministër të MFSK-së, me faktorë jashtë institucional jashtë Republikës së Kosovës, është ngritur në Kuvendin e Kosovës dhe është e njohur në opinionin publik. I propozoi Komisionit që për këtë çështje t’i kërkohej informacion Ministrisë së FSK-së, pra për çështjen e përfshirjes së zv. ministrit të FSK-së në komunikim jashtë institucional.

**Kryetari i Komisionit-** E konsideroj të arsyeshme kërkimin e informatës për këtë çështje dhe më pas të analizohet dhe të japim vlerësimin si Komision për këtë çështje.

Me shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës, e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

**Përgatitur nga:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Kryetari i Komisionit**

---

**Ahmet Isufi**